




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, si dhe nenit 12 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019, Kryetari i Komunes, duke vendosur sipas kërkesës së Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale të datës 09.06.2021, nxjerr:

**VENDIM  
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 2000 € (dy mijë euro), Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale për ta mbështetur financiarisht në kërkesën e saj të datës 09.06.2021 për realizimin e një vizite dy ditore në Republikën e Shqipërisë për të gjithë punësuarit e Administratës Komunale në Lipjan.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021, kategoria e subvencioneve në xhironlogarinë bankare të SHSPAK nr. 140100000845825 në Bankën Ekonomike .

**Neni 3**

Lidhur me mjetet e shpenzuara Shoqata Sindikale duhet të sjell dëshmi –faturë mbi shpenzimin e mjeteve dhe të njëjtat dorëzohen në Zyrën e Kryetarit të Komunës- Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore .

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet SHSPA në Lipjan.

1Nr. 400-30823

Lipjan, më 09.06.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

